



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM
Nr. 30, datë 20.01.2022

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në Kodin e Procedurës Penale, i ndryshuar, në Kodin e Procedurës Civile, i ndryshuar, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

A. GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Besjana Garxenaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Neni 108/a-2 i Kodit Penal”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Paulin Çera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; akuza: “Nenet 136/2 dhe 278/1 të Kodit Penal”.

B. GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Marsela Dervishi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmët, çështjen penale me kërkues: {...}; objekti: “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e akuzës”.

C. GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro dhe Elbana Lluri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale

me të pandehur: {...}; akuza: “Përvetësim i mallrave ose parave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtari kriminale”.

- II.** Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR